



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.119/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Rasim Rasimi dhe Afrim Shala anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit R. I., për shkak të veprës penale punimet ndërtimore të kundërligjshme nga neni 368 paragrafi 3 lidhur me paragrafi 1 të KPRK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan P.nr.714/19 të datës 05.07.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.1192/2023, të datës 25.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 26.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit R. I., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan P.nr.714/19 të datës 05.07.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.1192/2023, të datës 25.10.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan me aktgjykimin P.nr.714/19 të datës 05.07.2023, të dënuarin R. I. e ka shpall fajtor për veprën penale punimet ndërtimore të kundërligjshme nga neni 368 paragrafi 3 lidhur me paragrafi 1 të KPRK, për të cilën veprën e ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 7.000 (shtatë mijë) €, e të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i dënuari nuk e paguan gjobën e shqiptuar, dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim ku për çdo 20 € të gjobës do të llogaritet me një ditë burgim. Është obliguar i dënuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 170 €, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 € si dhe për kompensimin e Viktimave të Krimin shumë prej 30 €.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.1192/2023 e datës 25.10.2023, me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të dënuarit, e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë përkitazi me vendimin mbi dënimin ashtu që Gjykata e Apelit të dënuarit R. I., për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 4.000 (katërmijë) €, të cilën gjobë është i obliguar ta paguajë në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë ë këtij aktgjykimi. Në pjesën tjetër aktgjykimi i ankimuar mbetet i pandryshuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit R. I., avokati Shpetim Sadiku, për shkak të shkeljeve procedurale dhe aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuar kurse aktgjykimet kundërshtuara të ndryshohen ashtu që të dënuarit ti shqiptohet një sanksion më i ulët penal.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.69/2024 e datës 23.02.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435 paragrafi.1 lidhur me nenin 436 paragrafi.1 të KPPK-së dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit në kërkesë, pretendon se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, fare nuk e kanë aplikuar dispozitën e nenit 71 të KPRK, e që parasheh zbutjen e dënimit, kjo duke ju referuar provave të cilat gjenden në shkresat lëndës si dhe gjendjes faktike të vërtetuar gjatë shqyrtimit fillestar e që shkojnë në drejtim të rrethanave posaçërisht lehtësuese. Po ashtu, pretendohet se nuk janë aplikuar dispozitat e nenit 72 të KPRK, ku kjo dispozitë ka paraparë zbutjen e dënimit, sipas mbrojtjes dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë e i ndryshuar nga gjykata e shkallës së dytë është marr duke mos i zbatuar dispozitat që parashohin zbutjen e dënimit, dhe sikur gjykata do ti shqiptonte dënim më të ulët do të arrihej qëllimi i dënimit.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstaton se pretendimet e mbrojtësit të dënuarit janë të pabazuara, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë me të cilin është ndryshuar aktgjykimi i shkallës së parë në dobi të dënuarit përkitazi me dënimin, nuk janë të përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as me shkelje të ligjit penal, pasi që janë dhënë arsytet dhe janë paraqitur drejtë dhe qartë arsytet për faktet vendimtare që kanë të bëjnë lidhur me shqiptimin e sanksionit penal.

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të dënuarit, Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme fillimisht të theksoj faktin se i dënuari në shqyrtimin fillestar e ka bërë pranimin e fajësisë dhe si rezultat i konstatimit të gjykatës se janë përmbushur kriteret e përcaktuara, pranimi i fajësisë ishte aprovuar. Me këtë rast duhet theksuar fakti se pranimi i fajësisë në asnjë rrethanë nuk prejudikon caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, por e rëndësishme është që i dënuari ka qenë i njoftuar përkitazi me veprën penale, natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ndërsa i njëjti e ka pranuar fajësinë dhe atë në prezencë të mbrojtësit të tij.

Siç është theksuar edhe më parë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur për shkak të shkeljes së ligjit penal lidhur me dënimin e shqiptuar, përkatësisht faktin se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, të dënuarit i është shqiptuar dënim i lartë, ndërsa me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit është ndryshuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përkitazi me vendimin mbi dënimin dhe të dënuarit i është shqiptuar dënim më i ulët. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal dhe të dënuarit i është shqiptuar dënimi i përcaktuar në suaza të dispozitës së lartcekur për veprën penale për të cilën i dënuari është shpall fajtor.

Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatave të instancës më të ulët janë theksuar të gjitha rrethanat si lehtësuese dhe rënduese që kanë ndikuar në shqyrtimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Përndryshe, duhet theksuar faktin se nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimeve të shqiptuara, por e rëndësishme është se me rastin e shqyrtimit të dënimit nuk janë tejkaluara kompetencat ligjore, kështu që pretendimet e mbrojtësit në këtë drejtim nuk qëndrojnë.

Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385, paragrafi 5. të KPP, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet vetëm në rastet kur gjykata i ka tejkaluara kompetencat ligjore me rastin e shqyrtimit të dënimit, ndërsa në rastin konkret nuk ka ndodhur një gjë e tillë.

Në rast se nuk është fjala për këtë shkelje, vendimi për dënimin me këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik, mund të kundërshtohet vetëm nëse kjo pjesë e aktgjykimit është marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e cila do të mund të ndërlidhej me mungesën ose paqartësitë e arsyeve lidhur me vendimin për dënimin, mirëpo, në rastin konkret një pretendim i këtillë në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është paraqitur.

Nga arsyet e cekura më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.119/2024, më datë 26.02.2024

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka